

**Easypay sh.p.k.**  
**Raporti i Audituesit të Pavarur dhe**  
**Pasqyrat Financiare më dhe për**  
**vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

## **PËRMBAJTJA**

	<b>FAQJA</b>
<b>RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR</b>	<b>3</b>
<b>PASQYRAT FINANCIARE:</b>	
<b>PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR</b>	<b>5</b>
<b>PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TË TJERA PËRMBLEDHËSE</b>	<b>6</b>
<b>PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL</b>	<b>7</b>
<b>PASQYRA E RRJEDHËS SË MJETEVE MONETARE</b>	<b>8</b>
<b>SHËNIME SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE</b>	<b>10-34</b>

## RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

**Drejtuar: Ortakut të Shoqërisë “Easypay” shpk**

### **Raport mbi auditimin e pasqyrave financiare**

#### **Opinionin**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë “Easypay” shpk (Shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 dhjetor 2018, dhe pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 Dhjetor 2018, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Nderkombetare të Rportimit Financiar (SNRF).

#### **Baza për Opinionin**

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

#### **Çështje të tjera**

Pasqyrat financiare të “Easypay” shpk të përgatitura në përputhje me Standardet Nderkombëtare të Raportimit financiar, më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 janë audituar nga një auditues tjetër, raporti i të cilit më datë 27 qershor 2018, shpreh një opinion të pamodifikuar mbi këto pasqyra financiare.

## **Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

### **Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne, gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformatuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim

vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Për Net-SFS Kreston Sh.p.k.

**Rezar LLUKAÇEJ**  
Partner Angazhimi

*Tiranë më, 30 qershor 2019*



Për Albanian Audit Partners shpk

**Dashnor ÇARÇANI**  
Partner Angazhimi

*Tiranë më, 30 qershor 2019*



**Easypay Sh.p.k**  
**Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2018**

(shumat janë të shprehura në LEK)

<b>Aktive</b>	<b>Shënime</b>	<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	<b>Më 31 dhjetor 2017</b>
Aktive afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	<b>5</b>	16,710,472	15,881,262
Aktive afatgjata jomateriale	<b>6</b>	1,747,522	2,330,029
<b>Totali I Aktiveve afatgjata</b>		<b>18,457,994</b>	<b>18,211,292</b>
<b>Aktive afatshkurtra</b>			
Inventari	<b>7</b>	2,320,152	1,982,987
Llogari te arketueshme tregtare dhe te tjera	<b>8</b>	28,940,964	25,567,720
Te drejta te tjera	<b>9</b>	457,753	920,553
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre	<b>10</b>	144,297,849	115,733,731
<b>Totali I Aktiveve afatshkurtra</b>		<b>176,016,717</b>	<b>144,204,991</b>
<b>Totali I Aktiveve</b>		<b>194,474,711</b>	<b>162,416,283</b>
<b>Detyrime dhe kapitali aksionar</b>			
<b>Kapitali aksionar</b>			
Kapitali aksionar		50,000,000	50,000,000
Rezerva Ligjore dhe te tjera		10,773,104	23,102
Fitime te akumuluar		15,665,343	10,750,003
<b>Totali I kapitalit aksionar</b>		<b>76,438,447</b>	<b>60,773,105</b>
<b>Detyrime afatgjata</b>			
Kredi me palet e lidhura	<b>11</b>	6,000,000	0
<b>Totali I detyrimeve afatgjata</b>		<b>6,000,000</b>	<b>0</b>
<b>Detyrime Afatshkurtra</b>			
Llogarite e pagueshme tregtare dhe te parapagime	<b>12</b>	109,354,993	100,095,722
Detyrime tatimore	<b>13</b>	2,681,272	1,547,455
<b>Totali I detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>112,036,264</b>	<b>101,643,177</b>
<b>Totali I detyrimeve dhe kapitali aksionar</b>		<b>194,474,711</b>	<b>162,416,283</b>

*Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 10 deri në 34 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.*

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 janë aprovuar nga Drejtimi i shoqërisë më 27 qershor 2019 dhe firmosur nga:

**Administrator**

Lindita Shomo

**Easypay Sh.p.k****Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018***(shumat janë të shprehura në LEK)*

	Shënime	Per vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Per vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Faturime per shitjen e mallrave dhe produkteve te tjera	14	338,581,157	483,691,373
Faturuar per blerjen e mallrave dhe produkteve	16	(338,388,617)	(482,208,414)
<b>Te ardhura nga shitja e mallrave dhe produkteve te tjera</b>		<b>192,540</b>	<b>1,482,960</b>
<b>Të ardhurat nga ofrimi I sherbimeve</b>		<b>116,216,909</b>	<b>104,992,241</b>
Te ardhura te tjera		567,370	-
Shpenzime komisionimi	15	(62,357,637)	(59,910,340)
Marzhi bruto		54,619,183	46,564,860
			-
Shpenzime të personelit	17	(22,742,015)	(17,735,188)
Shpenzime amortizimi	5	(3,991,931)	(4,008,861)
Shpenzime të tjera	18	(11,227,341)	(11,718,350)
Të ardhura financiare		2,486,160	50,882
Shpenzime financiare		(492,867)	(357,204)
			-
<b>Fitimi para tatimeve</b>		<b>18,651,189</b>	<b>12,796,139</b>
			-
Tatimi mbi fitimin	19	(2,985,846)	(2,046,136)
			-
<b>Fitimi pas tatimeve</b>		<b>15,665,343</b>	<b>10,750,003</b>
			-
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse			-
			-
<b>Totali i fitimit gjithëpërfshirës për vitin</b>		<b>15,665,343</b>	<b>10,750,003</b>

*Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 10 deri në 34 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.*

**Easypay Sh.p.k****Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016****(shumat janë të shprehura në LEK)**

	Kapitali i Nënshkruar	Rezerva Ligjore	Rezerva te tjera	Fitimi i pashpërndarë / I vitit	Totali
<b>Pozicioni financiar i deklaruar më 31 Dhjetor 2016</b>	<b>32,100,000</b>	<b>14,815</b>	<b>6,223,408</b>	<b>8,074,879</b>	<b>46,413,102</b>
<b>Pozicioni financiar i deklaruar më 01 Janar 2017</b>	<b>32,100,000</b>	<b>14,815</b>	<b>6,223,408</b>	<b>8,074,879</b>	<b>46,413,102</b>
<b>Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:</b>					
Fitimi / Humbja e vitit				10,750,003	<b>10,750,003</b>
<b>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:</b>				<b>10,750,003</b>	<b>10,750,003</b>
<b>Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:</b>					
<b>Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:</b>					
Emetimi i kapitalit të nënshkruar	17,900,000		(14,290,000)		<b>3,610,000</b>
Dividendë të paguar					
<b>Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike</b>					<b>17,900,000</b>
<b>Transferimi ne rezerva</b>			8,074,879	(8,074,879)	
<b>Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2017</b>	<b>50,000,000</b>	<b>14,815</b>	<b>8,287</b>	10,750,003	<b>60,773,105</b>
<b>Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:</b>	<b>50,000,000</b>	<b>14,815</b>	<b>8,287</b>	10,750,003	<b>60,773,105</b>
Fitimi / Humbja e vitit				15,665,343	<b>15,665,343</b>
<b>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:</b>					
<b>Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:</b>				<b>15,665,343</b>	<b>15,665,343</b>
<b>Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:</b>					
Emetimi i kapitalit të nënshkruar					
Dividendë të paguar					
<b>Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike</b>					
<b>Transferim ne rezerva</b>			10,750,003		<b>10,750,003</b>
<b>Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2018</b>	<b>50,000,000</b>	<b>14,815</b>	<b>10,758,290</b>	<b>15,665,343</b>	<b>76,438,448</b>

*Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 10 deri në 34 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.*



Nr	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
<b>Fitim / Humbja e vitit</b>	<b>15,665,343</b>	<b>10,750,003</b>
<i>Rregullimet për shpenzimet jomonetare:</i>		
<i>Shpenzime konsumi dhe amortizimi</i>	3,991,931	4,008,861
<i>Fitime nga shitja e Aktiveve te qendrueshme te trupezuara</i>	-567,370	
<i>Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera</i>	-2,910,444	-14,324,998
<i>Rënie/(rritje) në inventarë</i>	-337,165	9,839,684
<i>Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme</i>	10,393,087	34,914,743
<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit</b>	<b>26,235,382</b>	<b>45,188,293</b>
<b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit</b>		
<i>Blerja e Aktiveve te qendrueshme materiale</i>	-4,556,133	-10,242,121
<i>Shitja e Aktiveve te qendrueshme materiale</i>	884,870	
<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit</b>	<b>-3,671,263</b>	<b>-10,242,121</b>
<b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit</b>		
<i>Arkëtime nga emetimi i kapitalit aksionar</i>		3,610,000
<i>financime nga aksionari kryesor</i>	6,000,000	
<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit</b>	<b>6,000,000</b>	<b>3,610,000</b>
<b>Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare</b>	<b>28,564,119</b>	<b>38,556,172</b>
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar 2018</b>	<b>115,733,731</b>	<b>77,177,559</b>
<i>Efekt i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare</i>		
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor 2018</b>	<b>144,297,849</b>	<b>115,733,731</b>

Pasqyra e rrjedhës së mjeteve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 10 deri në 34 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

## **1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM**

Shoqëria Easypay sh.p.k. është regjistruar pranë Gjykatës së rrethit Tiranë me vendim nr. 36864, dt. 28.12.2006, si shoqëri me përgjegjesi të kufizuar. Selia qendrore e saj ndodhet në adresën: Rruga "Ismail Qemali", Njesia Bashkiake Nr 5, Godina 30, Ap 7, Tiranë.

Shoqëria Easypay është liçensuar nga Banka e Shqipërisë, për të vepruar si institucion i parasë elektronike, për veprimtaritë financiare të emetimit të parasë elektronike dhe të gjitha shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave.

Shoqëria Easypay sh.p.k. është përfaqësues zyrtar i RIA Financial Services, në Shqipëri. Easypay kryen aktivitetin e transfertave të parave me RIA, nëpërmjet rrjetit të agjenteve të saj, në të gjithë vendin.

Shoqëria Easypay sh.p.k. ofron gjithashtu shërbimin e pagesave të utiliteteve, shërbimin e rimbushjeve elektronike të telefonise celulare, abonimeve televizive me pagese etj.

Në datë 31 dhjetor 2018, shoqëria kishte 31 punonjes. (2017: 26 punonjes)

## **2. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL**

### **2.1 Bazat e matjes**

Pasqyrat financiare janë hartuar dhe paraqitur mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe Ligjin 9477, datë 3.02.2006 "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", i ndryshuar. Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike. Këto pasqyra financiare janë përgatitur dhe paraqitur në monedhën shqiptare Lek ("LEK"), monedhë e vendit në të cilin Shoqëria zhvillon aktivitetin. Politikat kryesore kontabël janë shpjeguar më poshtë.

### **2.2 Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit që rezultojnë nga kryerja e transaksioneve të tilla dhe nga konvertimi i zërave monetarë në monedhë të huaj me kursin e fundit të vitit janë njohur në fitim dhe humbje.

Zërat jo monetarë nuk janë ri-konvertuar në fund të vitit dhe janë matur në bazë të kostos historike (konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit), përveç zërave jo-monetarë të matur me vlerën e drejtë të cilët konvertohen me kursin e datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Kurset zyrtare të këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën e raportimit janë si vijon:

	<b>31 dhjetor 2018</b>	<b>31 dhjetor 2017</b>
LEK / EUR	123.42	132.95
LEK / USD	107.82	111.10

## **2. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

### **2.3 Aktivet afatgjata materiale**

#### *(i) Njohja dhe matja*

Zëri aktivet afatgjata materiale është matur me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi.

Kostoja historike përfshin shpenzimet që janë të lidhura direkt me blerjen e aktivit

Kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato llogariten si zëra të veçantë (pjesë të rëndësishme) të aktiveve afatgjata materiale.

#### *(ii) Kostot vijuese*

Kostoja e zëvendësimit të një zëri të aktiveve afatgjata materiale është njohur në vlerën kontabël të zërit në qoftë se është e mundur që në të ardhmen perfitimet ekonomike të përfshira në atë zë do t'i vijnë Shoqërisë dhe kostoja mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve të përditshme të aktiveve afatgjata materiale njihen në të ardhurat ose shpenzimet kur ndodhin.

#### *(iii) Amortizimi*

Aktivevet afatgjata materiale amortizohen bazuar në metodën e vlerës së mbetur (siç kërkohet nga Legjislacioni i Tatimeve Shqiptare), duke përjashtuar përmirësimet e aktiveve të dhëna me qera të cilat amortizohen sipas metodës së amortizimit linear. Normat e amortizimit të përdorura janë si më poshtë:

#### **Kategoritë e aktiveve**

#### **Norma e Amortizimit**

Mjete Transporti	20%
Mobilje dhe pajisje	20%
Pajisje të tjera - Kompjuter	25%
Të tjera	20%

### **2.4 Aktivet afatgjata jo materiale**

Aktivet afatgjata jo materiale, të cilat konsistojnë tërësisht në programe, janë paraqitur me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjen e akumuluar nga zhvlerësimi, nëse ka. Amortizimi llogaritet duke përdorur metodën mbi vlerën e mbetur. Norma e amortizimit e përdorur për aktivet afatgjata jo materiale është 25%. Jeta e dobishme dhe metoda e amortizimit rishikohen në fund të çdo periudhe raportimi dhe efektet e ndonjë ndryshimi në vlerësim rregjistrohen në bazë prospektive.

*(shumat janë të shprehura në LEK, përveç se kur shprehet ndryshe)*

## **2. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

### **2.5 Zhvlerësimi i aktiveve jo financiare**

Vlerat kontabël e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përveç inventarit dhe tatimit të shtyrë, janë rishikuar në datën e raportimit për të përcaktuar në qoftë se ka ndonjë tregues zhvlerësimi. Në qoftë se ndonjë tregues i tillë ekziston, atëherë llogaritet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Humbja nga zhvlerësimi njihet në qoftë se vlera e mbartur e aktivitetit kalon vlerën e rikuperueshme të tij. Humbjet nga zhvlerësimi janë njohur në fitim ose humbje.

Humbja nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktiviteti ose njësisë së tij gjeneruese të parasë, tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Njësia gjeneruese e parasë është grupi më i vogël i identifikueshëm aktivitetesh që gjeneron rrjedhje parash që janë të pavarura nga aktivitetet dhe grupet e tjera.

Humbjet nga zhvlerësimi njihen në të ardhura dhe shpenzime. Shuma e rikuperueshme e një aktiviteti ose një njësie gjeneruese të parasë, është vlera më e lartë midis vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, rrjedhja e pritshme e ardhshme e parasë është skontuar me vlerën aktuale duke përdorur normën e skontimit para taksës që reflekton vlerën aktuale të parasë në treg dhe rreziqet specifike të aktivitetit.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse ka tregues që humbja nga zhvlerësimi nuk ekziston më dhe që ka patur ndryshime në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerën e rikuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret vetëm nëse vlera kontabël e aktivitetit nuk e kalon vlerën që do të ishte përcaktuar, neto me zhvlerësimin ose amortizimin, nëse zhvlerësimi nuk do të ishte njohur

### **2.6 Inventari**

Inventari matet me më të voglën midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Vlera neto e realizueshme është vlerësuar me çmimin e shitjes gjatë aktivitetit normal minus kostot e përfundimit dhe shpenzimet e shitjes.

Kostoja e inventarit përcaktohet bazuar në metodën e mesatares së ponderuar dhe përfshin të gjitha kostot e blerjes, kostot e konvertimit dhe kosto të tjera të ndodhura gjatë sjelljes së inventarit në vendndodhjen dhe gjendjen aktuale.

## **2. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

### **2.7 Instrumentat Financiare**

Shoqëria mban vetëm instrumente financiare jo-derivativ që përbëhen nga llogari të arkëtueshme dhe të tjera, mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre, huatë dhe llogari të pagueshme dhe të tjera. Instrumentat financiar jo-derivativ njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus, për instrumentat jo në vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes, duke i shtuar çdo kosto që lidhet drejtpërdrejtë me transaksionin. Pas njohjes fillestare, instrumentat financiar jo-derivativ maten si më poshtë. Një aktiv financiar njihet nëse Shoqëria bëhet pjesë në kushtet kontraktuale të aktivitetit. Shoqëria ç'regjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale mbi rrjedhjen e mjeteve monetare nga aktivet financiare skadojnë ose në qoftë se ajo transferon të drejtat për të arkëtuar rrjedhjen e mjeteve monetare kontraktuale të aktivitetit financiar në një transaksion në të cilin pothuajse të gjithë rreziqet dhe përfitimet e zotërimit të aktivitetit financiar transferohen. Blerjet dhe shitjet e aktiveve financiare regjistrohen në datën e tregtimit, p.sh. data në të cilën Shoqëria angazhohet për blerjen ose shitjen e aktivitetit. Detyrimet financiare ç'regjistrohen nëse detyrimet e Shoqërisë të specifikuara në kontratë skadojnë ose janë hequr ose anuluar.

#### *Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre*

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre përbëhen nga para në arkë, llogaritë rrjedhëse bankare dhe garancitë e vendosura në bankat tregtare vendase. Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre mbahen me koston e amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

#### *Llogari të arkëtueshme dhe të tjera*

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerë të drejtë dhe në vazhdimësi maten me koston e amortizuar minus humbjet nga zhvlerësimi.

Provigjoni për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme krijohet kur ka tregues objektiv që Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat sipas kushteve origjinale të llogarive të arkëtueshme.

Vështirësitë e konsiderueshme financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose të ndodhë një riorganizim financiar dhe mospagesa konsiderohen indikatorë që llogaritë e arkëtueshme janë zhvlerësuar.

Shuma e provigjoni është diferenca midis vlerës kontabël të aktivitetit dhe vlerës aktuale të rrjedhjes së ardhshme të mjeteve monetare, të skontuara me normën e interesit efektiv. Aktivitetet me maturitet afatshkurtër nuk skontohen. Vlera kontabël e aktivitetit zvogëlohet përmes përdorimit të një llogarie provigjoni dhe shuma e humbjes njihet në fitim ose humbje. Kur një llogari e arkëtueshme është e pambledhshme, vlera në bilanc mbyllet kundrejt një provigjoni për këtë llogari. Nëse shumat rikuperohen më vonë, ato regjistrohen në fitim ose humbje.

#### *Llogaritë e pagueshme dhe të tjera*

Llogaritë e pagueshme fillimisht njihen me vlerën e drejtë dhe në vazhdimësi maten me koston e amortizuar.

## **2. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

### **2.8 Instrumentat Financiare (vazhdim)**

#### *Njohja e zhvlerësimit të aktiveve financiare*

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka tregues objektiv që tregon se një ose disa ngjarje kanë patur një ndikim negativ në rrjedhjen e ardhshme të mjeteve monetare të vlerësuara të aktivit financiar.

Një zhvlerësim në vlerë në lidhje me një aktiv financiar të matur me kosto të amortizuar është llogaritur si diferencë mes vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të rrjedhjes të ardhshme të mjeteve të parasë të vlerësuara duke i skontuar me normën origjinale të interesit efektiv të aktivit.

Aktivet financiare individualisht të rëndësishme testohen për zhvlerësim mbi bazë individuale. Aktivet e mbetura financiare vlerësohen në mënyrë kolektive në grupe që ndajnë karakteristika të ngjashme të rrezikut të kredisë. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Një humbje nga zhvlerësimi anulohet nëse kthimi mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ka ndodhur pasi zhvlerësimi është njohur. Rimarrja njihet në fitim dhe humbje.

### **2.9 Kapitali aksionar**

Kapitali aksionar përbëhet nga kontributet në para të themelueses të Shoqërisë. Kapitali aksionar mbahet në monedhën vendase LEK. Kapitali aksionar i Shoqërisë është njohur me vlerën nominale.

### **2.10 Njohja e të ardhurave**

Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të shumës së marrë ose që është për t'u marrë nga Shoqëria. Të ardhurat reduktohen për kthimet e vlerësuara të klientit, uljet, skontot apo te tjera zbritje.

- **Të ardhurat nga shitje mallra**

Të ardhurat nga shitja e mallrave njihen kur të gjitha kushtet e mëposhtme janë plotësuar:

- Shoqëria ka transferuar tek blerësi rreziqet domethënëse dhe shpërblimet që lidhen me pronësinë e mallrave ;
- Shoqëria nuk zotëron përfshirje menaxheriale në shkallën që zakonisht lidhet me pronësinë dhe kontrollin efektiv mbi mallrat e shitura ;
- Shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri ;
- Është e mundur që përfitimet ekonomike të lidhura me transaksionin do të hyjnë në njësinë ekonomike
- Shpenzimet e bëra ose që do të bëhen në lidhje me transaksionin mund të maten me besueshmëri.

## **2. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

### **2.10 Njohja e të ardhurave (vazhdim)**

- **Të ardhurat nga shërbimet**

Të ardhurat nga shërbimet përfshijnë komisione shërbimi për transfertat e parave, për shërbimet e pagesave, shërbime të rimbushjeve elektronike etj. Të ardhurat nga komisionet, njihen kur kryhet shërbimi.

- **Të ardhura nga interesat**

Të ardhurat nga interesat përlogariten në bazë kohore, duke iu referuar principalit të papaguar dhe normës së interesit efektiv.

### **2.11 Përfitimet e punonjësve**

#### ***Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore***

Gjatë ecurisë normale të biznesit, Shoqëria bën pagesa në emër të saj dhe të punonjësve për kontributet e detyrueshme të pensioneve sipas legjislacionit vendor. Kostot të kryera në emër të Shoqërisë janë të paraqitura në të ardhura ose shpenzime në momentin e që ndodhin.

### **2.12 Tatimi mbi fitimin i periudhës dhe i shtyrë**

Tatimi mbi fitimin përbëhet nga tatimi i periudhës dhe tatimi i shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në të ardhura ose shpenzime përveç rasteve kur lidhet me zëra të njohur direkt në kapital ose në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse. Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar apo arkëtuar mbi fitimin e tatueshëm apo humbjen për vitin, duke përdorur normat e tatimeve që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi deri në datën e raportimit dhe çdo sistemim mbi tatimin e pagueshëm të lidhur me vitet e mëparshme. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin është 15% (2017: 15%) e të ardhurës së tatueshme. Tatimi i shtyrë njihet duke paraqitur diferencat e përkohshme midis vlerave kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që priten të aplikohen për diferencat e përkohshme kur ato të kthehen, duke përdorur normat e tatimeve që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi deri në datën e raportimit.

Një aktiv për tatimin e shtyrë njihet nëse është e mundshme që të ardhura të tatueshme të ardhshme do të realizohen kundrejt të cilave mund të përdoren diferencat e përkohshme. Aktivet e tatimit të shtyrë rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen deri sa nuk janë më të mundshme të realizohen përfitime tatimore të lidhura me të. Detyrimet për tatimin e shtyrë njihen për të gjitha diferencat e përkohshme të tatueshme.

*(shumat janë të shprehura në LEK, përveç se kur shprehet ndryshe)*

## **2. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

### **2.13 Provigjonet**

Provigjonet njihen kur si rezultat i ngjarjeve në të kaluarën, Shoqërisë i lindin detyrime (ligjore ose konstruktive) të cilat mund të parashikohen me besueshmëri dhe është e mundur që të ndodhë një dalje e përfitimeve ekonomike për shlyerjen e detyrimit. Nëse efekti është material, provigjonet janë përcaktuar duke ju zbritur vlerën e pritshme të rrjedhës së mjeteve monetare të skontuara me një normë para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të detyrimeve. Provigjonet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më mundësi që një rrjedhje burimesh që përfshin përfitime ekonomike për shlyerjen e detyrimit, të jetë e nevojshme për mbylljen e detyrimit, provigjonet rimerren. Provigjonet përdoren vetëm për qëllimin për të cilin janë njohur fillimisht. Nuk njihet provigjon për humbjet e ardhshme operative.

### **2.14 Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara**

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Për një detyrim të kushtëzuar jepet informacion shpjegues vetëm kur mundësia e një daljeje burimesh që përfshin përfitime ekonomike nuk ekziston më. Aktivitetet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare por jepet informacion shpjegues kur realizimi i të ardhurave është i mundur. Shuma e humbjes së kushtëzuar njihet si provigjon nëse është e mundur që ngjarje të ardhshme ta konfirmojnë atë, një detyrim që ka lindur deri më datën e raportimit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i humbjes.

### **2.15 Transaksionet me palët e lidhura**

Palët e lidhura përbëhen nga aksionarët dhe drejtimi i Shoqërisë, së bashku me entitetet që kontrollojnë, të cilët kanë një ndikim të rëndësishëm mbi aktivitetin dhe drejtimin e Shoqërisë. Në marrjen në konsideratë të çdo marëdhënie të mundshme me palët e lidhura, vëmendja i drejtohet thelbit të marëdhënies, jo vetëm formës ligjore.

### **2.16 Ngjarjet pas datës së raportimit**

Ngjarjet pas datës së raportimit që ofrojnë informacion shtesë në lidhje me pozicionin financiar të Shoqërisë në datën e raportimit (ngjarjet rregulluese) janë reflektuar në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas datës së raportimit që nuk janë ngjarje rregulluese janë paraqitur në shënimet e pasqyrave financiare nëse janë material.



### 3. APLIKIMI I STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR TË REJA DHE TË RISHIKUARA (SNRF)

#### 3.1. Standardet dhe Interpretime efektive në periudhën aktuale

Ndryshimet në standardet ekzistuese të publikuara nga Bordi i Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit, dhe interpretimet e miratuara nga Komiteti Ndërkombëtarë i Interpretimeve të Raportimeve Financiare, janë efektive për periudhën aktuale:

- **SNFR 9 “Instrumentat Financiare”** dhe ndryshimet pasuese (efektiv për periudhën vjetore më ose pas 1 janar 2018),
